

PROCESVERBAL
nga seanca e 4-ët publike e Këshillit të Agjencisë për Shërbime
Mediatike Audio dhe Audiovizuale
mbajtur më 2.3.2026

Anëtarët e Këshillit të Agjencisë të pranishëm nëpërmjet lidhjes video-konferencë: mr. Sasho Stefanovski, mr. Zirjeta Jajaga, mr. Gordana Majnova, Afrona Vërzivolli, Cvetanka Minovska dhe Viktor Pavlovski.

Anëtarët në mungesë të Këshillit të Agjencisë: Petar Xhurovski (pushim vjetor).

Në seancë nëpërmjet lidhjes video-konferencë ishte i pranishëm dhe dr. Zoran Trajčevski, drejtor i Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale.

Të punësuar nga shërbimi profesional të pranishëm nëpërmjet lidhjes video-konferencë: mr. Dragica Ljubevska, Cvetanka Mitrevska, Goran Radunović, dr. Ivana Stojanovska, Maja Damevska, mr. Ruzhica Boshnakoska-Jotevska, Sergej Todorovski.

Të pranishmit e tjerë: /

Kryetari i Këshillit, mr. Sasho Stefanovski, hapi seancën e 4-ët publike të Këshillit. Senca filloi në ora 15:30 dhe u mbajt nëpërmjet lidhjes video-konferencë.

Kryetari Stefanovski, në lidhje me rendin e ditës të propozuar, informoi se Pika nr.2 – „Arsyetim nga ShTR Prva Skopska TV ShPKNJ P Shkup (TV MTM Shkup), në lidhje me procedurën e inicuar për heqjen e lejes për transmetim televiziv“ do të renoncohet, duke pasur parasysh që transmetuesi ndërkohë ka përmbushur detyrimet ligjore.

Këshilli i Agjencisë njëzëri miratoi të korrigjuar si vijon:

RENDIN E DITËS

1. Arsyetim nga Shoqëria me përgjegjësi të kufizuar për radiodifuzion Mitanoski Vele SUPER RADIO Ohrid ShPKNJ P, në lidhje me procedurën për fshirjen nga regjistri i radiodifuzerëve.
2. Të ndryshme.

Kryetari i Këshillit, mr. Sasho Stefanovski, konstatoi se në seancë, e cila u mbajt nëpërmjet lidhjes video-konferencë, nuk ishte i pranishëm asnjë përfaqësues i Shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar për radiodifuzion Mitanoski Vele Super Radio Ohrid ShPKNJ P.

Duke pasur parasysh se seanca, në pajtim me ligjin, u caktua me qëllim që media të jepte arsyetim në lidhje me procedurën për fshirjen nga Regjistri i radiodifuzerëve, ndërsa përfaqësuesi nuk u paraqit në seancë, kryetari e deklaroi seancën e mbyllur.

Pika 2

Të ndryshme

Nuk kishte diskutim nën „Të ndryshme“.

**Agjencia për Shërbime Mediatike
Audio dhe Audiovizuale
Kryetari i Këshillit,
mr. Sasho Stefanovski**

Përktheu: Antoneta Shabani